

ALFA COURIER SERVICES (ACS) SHPK
Adresa : Autostrada Tr-Dr km 10 Rruga Dytësore, Vorë
Nipt: M11517018C

Tiranë më 18.09.2021

VENDIM I ASAMBLESË SË ORTAKEVE

Sot më datë 18.09.2021 në selinë e Shoqërisë, u mbajt mbledhja e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërisë me rend dite si më poshtë :

1. **Miratimi i të drejtës së njërit prej Ortakëve të transferojë kuotat e tij.**
2. **Ndryshimi i Administratorit të Shoqërisë.**
3. **Të ndryshme.**

Për sa i perket pikës së parë të rendit të ditës :

Njëri nga Ortakët e Shoqërisë, Z.Pandush LAKO, ka shprehur dëshirën për transferuar të gjithë kuotat e tij në Shoqëri në total prej 40%. Duke u bazuar në vendimin e Asamblesë së Ortakëve të datës 17.09.2021, ku u miratua pasqyra financiare provizore e prezantuar nga Audituesi Ligjor i zgjedhur prej Shoqërisë, konsiderohet kërkesë e arsyeshme që Ortaku i mësipërm të shesë kuotat e tij tek një ortak tjetër egzistues i Shoqërisë, vetëm me vlerën minimale të kapitalit të Shoqërisë..

Duke qenë se Ortaku që largohet është edhe Administrator, Shoqëria ndien nevojën e emërimit të një administratori të ri. Gjithashtu duke marrë parasysh që në Shoqëri nuk ka hyrë Ortak i ri dhe ortakët egzistues përbëjnë Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve në masën prej 100% të kapitalit të Shoqërisë, në bazë të statutit mund të ndryshojnë administratorin e Shoqërisë.

Në përfundim, Asambleja e Ortakëve, duke u bazuar në statutin e Shoqërisë dhe në legjislacionin në fuqi:

VENDOSI

1. Ortaku Z. Pandush Lako ka të drejtë të transferojë kuotat e tij me anë të shitjes tek Ortaku tjetër Z. Mertiaz SPAHIU.
2. Vlera e shitjes së kuotave do të jetë për të gjithë kuotat e tij prej 40% në Shoqëri në vlerën prej 100.000 (njëqind mijë) lekë.
3. Kontrata e Shitjes së Kuotave do të nënshkruhet privatisht nga të dy palët e mësipërme, shitësi dhe blerësi.
4. Pas nënshkrimit të kontratës së shitjes kuotat e Shoqërisë do të jenë përkatësisht :
 - Mertiaz SPAHIU..... vlera e kapitalit 2.100.000 lekë, pjesëmarrja në Shoqëri 70%.
 - Alket KUTROLLI.....vlera e kapitalit 450.000 lekë, pjesëmarrja në Shoqëri 15%.
 - Fredi KUTROLLI..... vlera e kapitalit 450.000 leke, pjesëmarrja në Shoqëri 15%.

5. Nga data 18.09.2021 largohet administratori egzistues Z. Pandush LAKO dhe ëmërohet Administrator i Shoqërisë Z. Mertiaz SPAHIU me afat nga data 18.09.2021 deri më 18.09.2025.
6. Administratori i ri i Shoqërisë ka të drejta të plota dhe asnjë limit në ushtrimin e detyrës së tij.
7. Autorizohet Administratori egzistues i Shoqërisë, i cili vetë apo duke autorizuar persona të tjerë, të depozitojë këtë vendim në QKB.

Pasi nuk kishte vendime të tjera për të marrë, vendimi i Asamblese te Ortakëve mbyllet me nr. Rendor 7 (shtatë).


ASAMBLEA E ORTAKËVE

Alket KUTROLLI




ALKET KUTROLLI

Fredi KUTROLLI



Mertiaz SPAHIU



Pandush LAKO

